



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:068799

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05789912

P.nr.844/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe sekretaren juridike Flutur Nagavci , në lëndën penale ndaj të pandehurit P. R. nga fshati . . . , me banim në fshatin . . . , Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale: Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme në vazhdimësi nga neni 332 paragrafi 1 lidhur me nenin 81 të Kodi Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: *KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1695/18 të datës 29.11.2018 pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore me datë 24.05.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit, A.Hasanaj, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit av. Edona Sina, mbrojtësit të akuzuarit av. Prek Kola si dhe të akuzuarit P. R., me datë **29.05.2024** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **04.06.2024** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **P. R.** , i biri i N. dhe i nënës T., e gjinisë D, data e lindjes . . . , në fshatin . B., tani me banim në fsh. P K Gjakovë, ka të kryer 4 klasë të shkollës fillore, i pa punë, i martuar ,atë i 8 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, me ID . . .

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

-Nga viti 1999 e deri në vitin 2023 në fshatin P, në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrare ka uzurpuar pronën e paluajtshme të dëmtuarit M. V. nga Republika e Serbisë, e të cilën pronë nga data 13.01.2023 e ka blerë dhe bartur në pronësi tani i dëmtuari A. B. dhe atë ngastrat kadastrale me numër të parcelave “. . . , në sipërfaqe prej 10293 m², . . . me sipërfaqe prej 3853 m², . . . , në sipërfaqe prej 899 m², . . . , në sipërfaqe prej 550 m², . . . , në sipërfaqe prej 1033 m², P-. . . në sipërfaqe prej 1867 m², e në sipërfaqe të përgjithshme prej 18495 m², zona kadastrale P.–

Gjakovë, ashtu që i pandehuri P. R. e shfrytëzon dhe mbanë ne posedim pronën e lartcekura pa ndonjë bazë juridike dhe nuk e lejon te dëmtuarin ta shfrytëzoj pronën e tij.

- **me çka ka kryer veprën penale: Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme në vazhdimësi nga neni i 332 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74, dhe 332par.1 lidhur me nenin 81të KPRK-së dhe nenit 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

I. **DËNIM ME BURGIM ME KUSHT** në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale në periudhën e verifikimit prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

II. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) euro në emër të ekspertizave dhe atë (200 euro në emër të ekspertizës së gjeodezisë dhe 300 euro në emër të ekspertizës nga komisioni IPF në Prishtinë)si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

III. Pala e dëmtuar M. V. nga Republika e Serbisë si dhe A.B. nga fshati . . Komuna Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.II.nr.1695/18 të datës 29.11.2018 , e ka akuzuar të akuzuarin P. R. nga fshati . . . Komuna Gjakovës, për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme në vazhdimësi nga neni 332 paragrafi 1lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke propozuar që ndaj të akuzuarit ti shqiptohet Urdhër ndëshkimor, me të cilën do ti shqiptohet dënimi me gjobë. Gjukata ka aprovuar propozimin e Prokurorisë Themelore dhe me Aktgjykimin P.nr.844/18 të datës 28.01.2029, të akuzuarin e ka shpallur përgjegjës dhe e ka dënuar me gjobë në shumë prej 600 Euro, si dhe të akuzuarin e ka obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30,00 €, në afat prej 15 ditëve, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. I akuzuari P. R. në afatin ligjor ka parashtruar kundërshtim kundër këtij Aktgjykimi me dt. 13.03.2019 dhe për këtë arsye pranë kësaj Gjykate u mbajt shqyrtimi gjyqësor.

Me që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet Gjykata ka mbajtur seancat e shqyrtimeve gjyqësore me datë 03.12.2019, 21.09.2020, 31.05.2023, 19.06.2023, 21.03.2023, 06.12.2023, 23.01.2024, 22.04.2024 dhe me datën 24.05.2024, ndërsa me datën 29.05.2024 është bërë shpallja dhe komunikimi i aktgjykimit.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.31.05.2023, lexoj aktakuzën PP/II.nr. 1695/218 të datës 29.11.2018, dhe deklaroi se duke marr parasysh se prokuroria e shtetit ka marr obligim në shqyrtimin e datës 17.05.2023 ku për shkak të ndryshimit të rrethanave me parashtrësën e datës 29.05.2023 është bërë edhe precizimin i dispozitivit të aktakuzës PP/II.nr. 1695/218 ku është përfshirë edhe pala e dëmtuar A. B. si dhe pas në fjalën përfundimtare pas administrimit të prova duhet të jetë si në vijim : Nga viti 1999 e deri në vitin 2023 në fshatin . . . , në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrare ka uzurpuar pronën e paluajtshme të dëmtuarit M. V. nga Republika e Serbisë, e të cilën pronë nga data 13.01.2023 e ka blerë dhe bartur në pronësi tani i dëmtuari A. B. dhe atë ngastrat kadastrale me numër të parcelave “. . . , në sipërfaqe prej 10293 m² , . . . me sipërfaqe prej 3853 m², . . . , në sipërfaqe prej 899 m², . . . , në sipërfaqe prej 550 m², . . . , ne sipërfaqe prej 1033 , m² P-. . . , në sipërfaqe prej 1867 m², e ne sipërfaqe te përgjithshme prej 18495 m², zona kadastrale . . . –Gjakovë, ashtu qe i pandehuri P. R. e shfrytëzon dhe mbanë ne posedim pronën e lartcekura pa ndonjë bazë juridike dhe nuk e lejon te dëmtuarin ta shfrytëzoj pronën e tyre.

2. Fjala përfundimtare e palëve

Në fjalën përfundimtare prokurori A.Hasanaj deklaroi se: gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me administrimin e provave materiale dhe personale, është vërtetuar ne tërësi gjendja faktike si ne dispozitivin e aktakuzës se përmirësuar me përjashtim të vetëm te ngastrave dhe sipërfaqes se shfrytëzuar, ku tani e bëjë përmirësimin e dispozitivit sa i përket ngastrave te shfrytëzuara përkatësisht te uzurpuara nga i akuzuari ashtu që ne rreshtin e katër të dispozitivit te aktakuzës se përmirësuar ashtu që pas fjalës me numër te parcelave duhet te jetë : “. . . , në sipërfaqe prej 10293 m² , . . . me sipërfaqe prej 3853 m², . . . , në sipërfaqe prej 899 m², . . . , në sipërfaqe prej 550 m², . . . , ne sipërfaqe prej 1033 , m² P-. . . , në sipërfaqe prej 1867 m², e ne sipërfaqe te përgjithshme prej 18495 m² ,zona kadastrale . . . –Gjakovë, ashtu qe i pandehuri P. R. e shfrytëzon dhe mbanë ne posedim pronën e lartcekura pa ndonjë bazë juridike dhe nuk e lejon te dëmtuarin ta shfrytëzoj pronën e tij .Kjo gjendje faktike është vërtetuar me dëgjimin e te dëmtuarit në cilësi te dëshmitarit A. B. i cili ka vërtetuar faktin se me dt. 13.01.2023,e ka bartë këtë pronë ne emër të tij nga ish pronari M. V. duke lidhur kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë te cilën pronë pranë zyrës kadastrale e ka regjistruar dhe bartur ne emër te tij ,mirëpo gjere tani nuk është lejuar që te hy ne posedimin dhe shfrytëzimin e saj te lirë ,për shkak se i akuzuari e mbanë ne mënyrë te kundërligjshme dhe nuk ka pranuar asesi te lirojë këtë pronë .Po ashtu edhe me dëgjimin e ekspertit te gjeodezisë B. M. është vërtetuar fakti se i njëjti pas kërkesës se kësaj gjykate ka dal ne vendin e ngjarjes dhe ka bërë evidentimin dhe konstatimin e saktë te gjithë paluajtshmërisë që evidentohet ne emër te A. B.t ,e te cilën e shfrytëzon këtu i akuzuar P. R., duke evidentuar se dy parcela janë ne tërësi në shfrytëzim nga i njëjti ,ndërsa katër te tjera pjesërisht .Gjithashtu kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe me administrimin e provave materiale dhe atë certifikatës se pronësisë te dt. 23.02.2023,nga e cila është vërtetuar fakti se paluajtshmeri e cila është objekt i aktakuzës ,është

bartur ne emër te dëmtuarit A. B. , ekspertiza gjeodezike nga e cila janë precizuar paluajtshmëritë pjesërisht dhe ne tërësi qe i ka në shfrytëzim i akuzuari, kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë dt. 13.01.2023, nga e cila është vërtetuar fakti se tani i dëmtuari A. B. këtë paluajtshmëri dhe disa paluajtshmëri tjera ne emër te M. V.,i ka blerë sipas marrëveshjes se lirë dhe te njëjtat i ka prezantuar për bartje te drejtës se pronësisë pranë organit kadastral . Këto prova janë prova te cilat kanë mbështetje edhe ne dëshmitë e te dëmtuarit dhe dëshmitarit përkatësisht ekspertit gjeodezik te cilat e vërtetojnë një fakt te pakontestueshëm dhe atë se i dëmtuari A. është pronar i këtyre paluajtshmërive në bazë te kontratës se shitblerjes, dhe i njëjti² nuk mund te i shfrytëzojë si pronar per shkak se i akuzuari ne mënyrë arbitrare dhe pa ndonjë bazë juridike i shfrytëzon dhe nuk lejon te dëmtuarin qe te disponojë lirshëm me pronën e tij . Kjo gjendje faktike pjesërisht është vërtetuar edhe me mbrojtjen e te akuzuarit i cili e pranon faktin se është ne shfrytëzim te këtyre paluajtshmërive , e po ashtu e pranon faktin se i dëmtuari është bere pronar i tyre .Prandaj gjykata mbrojtjes se tij sa i përket pretendimeve se e ka shfrytëzuar me pëlqimin e ish pronarit ,duke e orientuar çështjen ne drejtim te kontestit civil, nuk duhet ti falet besimi sepse ne këtë rast i akuzuari nuk ka arritur qe ti prezantojë gjykatës ndonjë dëshmi qoftë materiale apo personale ,se ka hyrë me pëlqim nga ish pronari , prandaj qëllimi i vetëm është shmangia nga përgjegjësia penale e po ashtu mbrojtja e tij nuk gjenë mbështetje ne asnjë provë te administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe si te tillë është e paqartë dhe kontradiktore ,andaj edhe gjykata nuk duhet te ja falë besimin. Gjykatës i propozoi se me qe është vërtetuar përtej dyshimit te bazuar mirë se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale ,te nijetin ta shpallë fajtor , ta dënojë sipas ligjit duke vlerësuar si rrethanë renduese dashjen dhe qëllimin e tij te vazhdueshëm për mos lirim e kësaj prone edhe përkundër insistimit te dëmtuarit, dhe njëherit te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në fjalën përfundimtare Përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarit A. B. av. Edona Sina , të përgatitur me shkrim ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër të pandehurit P. R. për veprën penale të uzurpimit, u vërtetua në mënyrë të plotë dhe të qartë përgjegjësia e tij penale. Nga dëgjimi i palëve dhe provat materiale të administruara u vërtetuan të gjitha elementet e veprës penale të cilat formojnë figurën penale të uzurpimit me të cilën i pandehuri ngarkohet. Pushtimi i pronave që janë objekt i kësaj çështje është bërë nga i pandehuri pa asnjë bazë juridike pronësore andaj është totalisht i kundërligjshëm, e për më tepër për këtë ka qenë shumë i vetëdijshëm që i njëjti banon në tokë të huaj pa asnjë kontratë/marrëveshje apo punë të vlefshme juridike siç e parasheh ligji. Fillimisht më lejoni të sqaroj apo të eliminoj të gjitha dilemat eventuale për lidhjen juridike të këtij rasti si çështje civile. Ekzistimi apo mos ekzistimi i kontestit civil nuk kufizohet e as nuk e përjashton përgjegjësinë penale. Edhe pse në këtë figurë të veprës penale patjetër që ndërthuren elemente civile, mirëpo vetë ligjvënësi e ka paraparë një vepër të tillë pikërisht për rrethana që i përshtaten rastit konkret. Një vepër e tillë penale është paraparë nga ligjvënësi pikërisht për arsyet se pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë shumë prona janë uzurpuar që kanë qenë në pronësi të serbëve, pavarësisht rrethanave e tensioneve në atë kohë, një veprim i tillë është i kundërligjshëm pavarësisht çfarë kombësie ka pala e dëmtuar. [Komentari i Kodit Penal të Kosovës: ‘Për shkak të rrethanave të krijuara pas luftës dhe pushtimeve masive të pronave të huaja të braktisura, është paraqitur nevojë imediate që pronarëve të pronave të këtyra të paluajtshme t’i ofrohet mbrojtje edhe përmes drejtës penale, me qëllim që abuzimi i këtyre me prona të huaja të parandalohet’] Faktet jokontestuese që janë vërtetuar gjatë këtij shqyrtimi janë se në këto parcela që janë objekt i kësaj çështje, pronarë kanë qenë fillimisht dy vëllezërit serb M. dhe M. V., me tutje

sipas historiatit në mes tyre është zgjidhur trashëgimia mes familjarëve të tyre, e pasi është zgjidhur kjo trashëgimi të gjitha pronat janë blerë dhe kanë kaluar në pronësi legjitime të dëmtuarit A. B.. Pretendimet e mbrojtjes lidhur me çështjen e trashëgimisë, se a kanë pasur apo jo trashëgimtarë të dy pronarët fillestar nuk është çështje relevante për procedurën penale, ajo çfarë na duhet neve është se pronësia në regjistra kadastrale ka kaluar në mënyrë të ligjshme dhe të rregullt te i dëmtuari A. B.. Sido që të jetë, pavarësisht se kush ka qenë pronar legjitim, që nga pas lufta këto prona nuk kanë qenë në posedim të pronarëve legjitim por në shfrytëzim nga i pandehuri P. R.. I njëjti ka qenë i vetëdijshëm dhe i mirë informuar se kush ka qenë pronar para luftës. Kjo vërtetohet edhe me CD e bashkangjitur në shkresa të lëndës ku në video-emision publik televiziv të vitit 2016, respektivisht në minutën 3:33 vetë i pandehuri P. R. thotë ‘kjo shtëpi është e shkaut’ më tutje në minutën 5:35 i pandehuri në intervistë deklaron ‘nuk marr social për shkak se mkanë thanë ke nxonë tokë të huj, po unë që e kam nxon tokën kjo tokë nuk m’qet me hëngër’, nga kjo vërtetohet se institucionet përkatëse të Kosovës me të drejtë ja kanë mohuar të drejtën e përfitimit social sepse i njëjti ka uzurpuar pronën e huaj dhe ka refuzuar t’a lëshoj. Edhe më tutje, i pandehuri e ka ditur që nga janari 2023 këto prona janë blerë nga A.B., dhe prapë ka refuzuar të i liroj. I dëmtuari A.me mirësjellje dhe qytetari e ka njoftuar disa herë verbalisht se tashmë ato toka janë në pronësi të tij – në pronësi të një shqiptari dhe duhet të i liroj mirëpo i njëjti me agresivitet ka refuzuar, njëjtë ka vepruar edhe kur ndërmjetësues të fshatit janë munduar të ja sqarojnë të njetit se tokën duhet ta lëshoj sepse tashmë e ka blerë një shqiptar. Nga kjo vërtetohet elementi më i rëndësishëm i kësaj vepre penale – dashja. I pandehuri P. R. asnjëherë në asnjë moment nuk e ka pasur pëlqimin e të dëmtuarit A. B. për të i shfrytëzuar ato prona, ndërsa të dëmtuarit serb për arsye të njohura politika as nuk kanë mundur të vijnë të afrohen te pronat e tyre pas luftës. Andaj, e ritheksojmë se gjatë këtij shqyrtimi janë vërtetuar këto fakte vendimtare që i pandehuri a.) ka qenë në dijeni që nuk është pronar legjitim b.) nuk ka pasur pëlqim nga të dëmtuarit për të i shfrytëzuar ato prona c.) ka vazhduar shfrytëzimin e pronave përkundër paralajmërimeve që të i liroj ato. Po ashtu, në këtë shqyrtim janë administruar si prova edhe kontratat e shit-blerjes së parcelave dhe dokumentacionin kadastral, ku vërtetohet se të gjitha parcelat që janë objekt i çështjes janë të blera në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme përmes kontratave të noterizuara në mes të dëmtuarve. Ndërlidhur me këtë i propozojmë gjykatës që të ja fal besimin e plotë edhe ekspertizës gjeodezike të punuar nga ing.B. M. të datës 24.08.2023, në të cilën saktësisht janë sqaruar cilat prona dhe në çfarë sipërfaqe të saktë janë në shfrytëzim nga i pandehuri P. R.. Kërkojmë nga gjykata të i falet besimi deklaratës së palës së dëmtuar A.B. pasi e njëjta është në përputhje me të gjitha provat tjera materiale. Shtojmë se vetë qasja e qëndrimi i të pandehurit P. R. gjatë seancave gjyqësore vërteton se sa nevrík e kokëfortë është sa i përket kësaj çështje, e në anën tjetër sa bashkëpunues e me mirësjellje është munduar të tregohet i dëmtuari duke i ofruar edhe zgjidhje që të dalë në një banesë sociale vetëm që të ja liroj pronat e veta. I propozoj gjykatës që të mos ja fal besimin deklaratës së të pandehurit gjatë mbrojtjes së tij, pasi që deklarata e tij në tërësi ishte non-sense, duke u thirrur në ide patriotike që për të gjithë ne janë të tejkaluara e konsumuara, e gjithë kjo vetëm që të i shmanget përgjegjësisë së tij penale. Deklarata e tij nuk gjen asnjë mbështetje të vetme në provat materiale në lëndë, mbrojtja nuk ka ofruar asnjë provë apo argument juridik mbi të drejtën e pretenduar përveç deklarimeve të thata, ngritjes së tensioneve e presioneve të kota ndaj palës së dëmtuar. Në bazë të lartcekurave, i propozojmë gjykatës që të pandehurin P. R. ta shpall fajtor për veprën për të cilën ngarkohet e të t’a dënoj sipas ligjit, si dhe t’a obligoj që të i liroj të gjitha pronat e precizuara sikur në ekspertizën gjeodezike në shkresat e lëndës.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit P. R., av. Prek Kola të përgatitur me shkrim ka deklaruar se: Sipas aktakuzës së prokurorisë i mbrojturi im P. R. është duke u akuzuar se nga viti 1999 e në vijim, në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të dëmtuarit M. V. nga R. Serbisë, në atë mënyrë që edhe pse i dëmtuarit i'a tërheq vërejtjen që mos ta shfrytëzoj pronën, i pandehuri ka vazhduar që të e shfrytëzoj dhe punoj pronat e evidentuara sikur në aktakuzën...pa pasur ndonjë bazë të vlefshme juridike, me çka ka kryer veprën penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme në vazhdimësi nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 81 par.1 të KPRK-së. Si mbrojtje mendon se pas administrimit të provave materiale dhe personale, nuk është provuar se i mbrojturi im P. R. e ka uzurpuar pronën e paluajtshme të dëmtuarit A. B., pra nuk ekzistojnë veprimet inkriminuese për të kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Bazuar në provat e administruara materiale dëgjimit të dëmtuarit A. B., deklarata e të akuzuarit, nuk ekziston dashja për kryerjen e veprës penale të uzurpimit, po ashtu nga përshkrimi faktik i veprimeve të akuzuarit në aktakuzë nuk mund të rezulton se me veprimet e të mbrojturit tim përmbushëm elementet e veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 81 par.1 të KPRK-së, sepse sipas dispozitave ligjore të nenit 332 par.1 kjo vepër penale kryet kur atëherë kryesi “*në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj*”, pra nga dispozita ligjore shihet qartë se për kryerjen e kësaj vepre penale, duhet të ekzistojë dashja e kryesit se i njëjti me vetëdije po e uzurpon pronën e huaj pa lejen e pronarit, me çka jepet të kuptojmë se elementet e kësaj vepre penale plotësohen atëherë kur kryesi e uzurpon pronën pa lejen dhe pa pëlqimin e pronarit të pronës. Nga administrimi provave, dëgjimi i të akuzuarit P. R. u vërtetua fakti se i njëjti në vitin 1999 kur është kthyer pas përfundimit të luftës në Kosovë nga Shqipëria dhe është vendosur në pronën- shtëpinë e M. M. pasi nuk kishte se ku të strehohej me familjen e tij dhe vazhdon të qëndroj edhe në ditët e sotit, duke e shfrytëzuar këtë pronë me mirëbesim, se prona është e M. M. e kishte kuptuar pasi kishte hyr në shfrytëzim, nga dëshmia e të dëmtuarit A. B. u vërtetua se pronat që janë objekt i kësaj çështje, i ka blerë në dhjetor të vitit 2022 nga pronari M. V., kurse në janar të vitit 2023 e ka paguar në tërësi çmimin për blerjen e pronave, pra kjo rrethanë u vërtetua edhe nga kontrata e datës 13.01.2023 për shitblerjen e paluajtshme risë LRP.nr.577/23 nr. Ref.124/23, ku nga kjo vërtetohet se i dëmtuari A. B. është bërë pronar legjitim i këtyre parcelave në vitin 2023. Bazuar në provat materiale, në dëshminë e të dëmtuarit dhe të akuzuarit, vërtetohet fakti se i akuzuar është hyrë në posedim të këtyre pronave me qëllim të strehimit me familjen e tij pasi nuk kishte ku të strehohej sepse lufta kishte shkatërruar çdo gjë dhe se me rastin e hyrjes në posedim në atë kohë nuk ka qenë pronar legjitim i këtyre pronave i dëmtuari A. B. dhe nuk ka ekzistuar dashja për uzurpimin e pronave dhe i akuzuari dhe familja e tij nuk janë futur me qëllim të uzurpimit, po për shkak të strehimit se nuk kishin ku të jetojnë. Nga provat e administruara me pa mëdyshje u vërtetua fakti se në kohën kur i akuzuari ka hyrë në shfrytëzim të pronës për të cilën akuzohet në vitin 1999, pronar nuk ka qenë këtu i dëmtuari A. B., të cilin i akuzuari nuk e ka njohur në atë kohë, kjo vërtetohet nga vet deklarata e të akuzuarit dhe dëmtuarit, ku i akuzuari deklaroi se nuk e kam njohur këtu të dëmtuarin A. B. pasi ky në vitin 1999 është hyrë në posedim të shtëpisë së M. M. dhe për këtë pronë pasi ka hyrë në posedim është njoftuar se ka qenë e M. M., se i dëmtuari nuk ka qenë pronar i këtyre pronave u vërtetua edhe nga vetë i dëmtuari dhe nga provat materiale siç është Historiati i pronës i datës 24.02.2020, ku vërtetohet se pronar deri në vitin 2023 nuk ka qenë i dëmtuari A. B.. Mbi bazën e fakteve të vërtetuara në këtë shqyrtim, nuk është vërtetuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohet i mbrojturi im, pasi mungon

dashja në kryerjen e kësaj vepre penale, pra siç shihet qartë se këtu nuk kemi të bëjmë me një raport penalo-juridik por me një raport civilo-juridik për lirim të pronës, ku në këtë gjykatë është paraqitur padi me kontest civil ndaj të akuzuarit që është duke u zhvilluar me numër të lëndës C.nr.614/2017 2019:089937. Pas analizimit të provave për secilën veç e veç, përfundimisht kërkojmë nga gjykata që të akuzuarin ta liron nga aktakuza, sepse mungon elementi i dashjes për kryerjen e kësaj vepre penale dhe po ashtu i akuzuari është hyrë në posedim të pronës para 23 viteve, kur është bërë i dëmtuari A. B. pronar i pronës, çka do të thotë se i akuzuari nuk ka hyrë në pronë për ta uzurpuar, por për tu strehuar me familje dhe nuk ka pasur dashje dhe qëllim uzurpimit të pronës në mënyrë të kundërligjshme dhe se me veprimet e të akuzuarit nuk formohen elementet e veprës penale të uzurpimit të pa ligjshëm të pronës.

I akuzuari P. R., në fjalën përfundimtare deklaroi e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe shtojë se kur kam hyrë në tokën e M. unë kam pasur presion nga dy fshatrat që të lirojnë pronat, po ashtu në vitin 2001 ka ardhur Habitatat për të më dëbuar nga kjo pronë, i kanë lënë shenjat e verdha për me e lirua atë pronë, me kanë ftuar në Habitatat ne Pejë ,ku edhe kam shkuar, më kanë pyetur se a je në tokë të M. i kam thanë jo sepse jam në tokën e M.. Habitatat me kanë thanë se a i përgjigjes i kam thanë po dhe kaq ka mbetur procedura.

3. Konstatimet e gjyqtarës së vetme gjykuese

Gjate shqyrtimit gjyqësor me rastin e procedimit të provave dhe vlerësimit të tyre ,një nga një e ne lidhje me njëra tjetrën komfor nenit 360 të KPP-ës, Gjykata vlerësoi këtë gjendje faktike.

Se i akuzuari : nga viti 1999 e deri në vitin 2023 në fshatin P., në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrare ka uzurpuar pronën e paluajtshme të dëmtuarit M. V. nga Republika e Serbisë, e të cilën pronë nga data 13.01.2023 e ka blerë dhe bartur në pronësi tani i dëmtuari A. B. dhe atë ngastrat kadastrale me numër të parcelave “. . . , në sipërfaqe prej 10293 m², . . . me sipërfaqe prej 3853 m², . . . , në sipërfaqe prej 899 m², . . . , në sipërfaqe prej 550 m², . . . , në sipërfaqe prej 1033 m², P-. . . në sipërfaqe prej 1867 m², e në sipërfaqe të përgjithshme prej 18495 m², zona kadastrale P.–Gjakovë, ashtu që i pandehuri P. R. e shfrytëzon dhe mbanë në posedim pronën e lartcekura pa ndonjë bazë juridike dhe nuk e lejon të dëmtuarin ta shfrytëzojë pronën e tij.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetojë nga provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor si: Deklarata e të dëmtuarit M. V.përmes parashtresave të datës 24.03.2023, 21.04.2023 ; 16.05.2023 , deklarata e dëmtuarit A. B. në cilësi të dëshmitarit , deklarata gjeodetit B. M. në cilësi të ekspertit e kopja e fletëpagesës në emër të A. B., Historiati i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë me nr.11-940-02-2200/20 i datës 24.02.2020 , Aktvendimit të trashëgimisë, T.nr. 50/95 të datës .29.05.1995, Aktvendimit të trashëgimisë, T.nr.227/10 të datës 23.12.2010, Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë T.nr.50/1995 i datës 29.05.1995 , Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë T.nr. 227/2010 i datës 23.12.2010 , Kontrata për shitblerjen e paluajtshme risë LRP.nr.rendor 577/2023 dhe LRP nr.ref.124/202 të datës 13.01.2023,certifikata e lëshuar nga AK i Kosovës nr.ref.479/23 i datës 23.02.2023 nga e cila vërtetohet paluajtshmëria e bartur në emër të A. B., aktvendimi i zyrës kadastrale në Gjakovë nr.967/23 i datës 18.01.2023, ekspertiza e gjeodetit e datës 23.08.2023, aktvendimi nga zyra kadastrale Komunale nr.967/23 e datës

17.01.2023, ku është aprovuar kërkesa e parashtruar nga A. B. mbi bartjen e posedimit-blerjen e paluajtshmërisë sipas datës së shitblerjes, kopja e planit e lëshuar nga ZKK e datës 15.01.2023, si dhe deklarimi i të pandehurit dhënë gjatë mbrojtje së tij

3.1 Deklaratat e dëshmitarëve

3.1.1 I dëmtuari M. V. përmes parashtrësave në gjykatë në mënyrë elektronike ka deklaruar se: Në gjykatën tuaj i keni pasur informacione të plota. Procedurat e trashëgimisë si për babanë tim, të ndjerin M., ashtu edhe për xhaxhain tim, të ndjerin M., janë zhvilluar në gjykatën tuaj. Provat kryesore janë në arkiv të gjykatës suaj. Pikërisht në gjykatën tuaj i keni provat kryesore. Se P. R. e ka uzurpuar pronën tonë, nuk është e kontestueshme. Se, cila sipërfaqe është uzurpuar keni pasur mundësi të e vërtetoni qyshë në vitin 2018, por edhe tani në çdo kohë. Uzurpatori P. R. do të identifikojë pjesët të paluajtshmërisë time të dikurshme që ai i ka uzurpuar. Ai nuk e mohon këtë. Nëse i keni siguruar të dhënat e nevojshëm, do të shihni se bëhet fjalë për një pronë të madhe, e cila është trashëgimi e babait tim – tani të ndjerit M. (B.) V. dhe xhaxhait tim – të ndjerë M. (B) V., i cili u vra në pronën e tij në vitin 1999, duke mbrojtur të njëjtën pronë. Në gjykatën tuaj janë zhvilluar procedurat të trashëgimisë. Procedura për të atin tim M. (B.) V. është kryer me Aktvendim të Gjykatës Komunale në Gjakovë me . T.nr.50/95 të dt. 29.05.1995. Procedura për xhaxhain tim M. (B) V. gjithashtu është kryer me Aktvendim të Gjykatës Komunale në Gjakovë T.nr.227/10 të datës 23.12.2010. Prona është bartur përmes procedurave të kryera në gjykatën tuaj, në emrin tonë, trashëgimtarëve të M.it dhe M.s, dhe atë gjithsej 11.5 hektarë. Është një pronë e madhe. M.i dhe M. nuk jetojnë më. Gjithashtu, të gjitha informatat i keni edhe në gjykatën tuaj, si dhe në kadastrën në Gjakovë. Përndryshe, unë e kam njoftuar blerësin A. B. për këtë procedurë penale në mënyrë që ai të përfshihej në këtë lëndë, sepse nga dt. 14.01.2023 ai është bërë pronar dhe mbi këtë bazë është palë e dëmtuar, ndërsa unë mbetem si palë e dëmtuar për periudhën kohore prej dt. 12.06.1999 deri më dt. 13.01.2023.

3.1.2 I dëmtuari A. B. në cilësi të dëshmitarit, gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 31.05.2023, duke u deklaruar fillimisht në pyetjet e parashtruara nga prokurori i shtetit deklaroi se e njohë M. V., ndërsa të pandehurin P. R. në nuk e kam njohur por tani e njoh. M. V.in e njoh ngase nga i njëjti e kam blerë paluajtshmërinë ndërsa P. e njoh pasi e kam blerë pronën nga M. V.i dhe e di se ky e mbanë këtë pronë. Shtoi se në dhjetor të 2022, e kam blerë pronën nga pronari M. V. por në janar të vitit 2023, e kam paguar në tërësi këtë paluajtshmërinë dhe pas 2 dite me datën 13.01.2023, prona është regjistruar në kadastrë në emrin tim. Këtë pronë e kam blerë në tërësi nga M. V.i, Në pyetjen e prokurorit: po personat S. V., I. V., M. V. dhe M.ka Gj. e lindur V. a i njeh, nëse po si i njehë dëshmitari ka deklaruar: po i njohë në bazë të shtijës së parcelave, meqë M.i ka qenë bashkëpronar me S., I., M.n dhe M.ken, në trashëgiminë e M.it ndërsa trashëgimia e M., me aktvendim të trashëgimisë ka kaluar tek M. V.i të cilat prona në tërësi i kam blerë unë. Shton se unë e kam blerë tërë pasurinë e personave të lartcekur të cilat gjendjen në fshatin P. dhe D, duke shtuar se ato janë një zonë kadastrale dhe për këtë kam dokumentacion, kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me numër LRP.nr. rendor 577/2023, me numër reference 124/2023 të datës 13.01.2023, të përpiluar te noteri F.Z., po ashtu këtë pronë edhe e kam regjistruar në Agjensionin Kadastral të Kosovës me datën 17.01.2023, për çka edhe posedoj edhe certifikatën e pronësisë e të

gjitha këto prova si dhe me prova shtesë përcjellëse të cilat nëpërmjet përfaqësueses sime i kam dorëzuar në gjykatë dhe në prokurori. Në pyetjen e prokurorit se kur e keni bërë kontratën e shitblerjes me personat e lartcekur a të kanë treguar ata se kjo pronë a ka ndonjë mangësi apo ka qenë në posedim të tyre? Dëshmitari ka deklaruar se: po të njëjtit më kanë sqaruar se atë pronë në mënyrë të kundërligjshme është duke e mbajtur këtu i akuzuari P. R. për çka ata e kanë denoncuar në prokurori dhe gjykatë e cila procedurë është në zhvillim e sipër. Nuk kam hyrë në ato prona edhe pse kam kontaktuar me këtu të akuzuarin P. R. dhe i kam treguar të njëjtit se unë e kam blerë këtë pronë, por i njëjti më ka thënë se nuk dal prej këtu pa mi falë dy hektarë të tokës ndërsa unë ia kam ofruar një banesë sociale meqenëse ai është vetëm me bashkëshorten mirëpo ai nuk ka pranuar. Shtoi se tek P., nuk kam qenë por P ka qenë te djali i axhës në muajin Janar të vitit 2023, kur ka marr vesh që e kam blerë këtë pronë. Me datën 26.04.2023, kur ka qenë i caktuar shqyrtimi gjyqësor në praninë e djalit të axhës M. B., janë bërë të gjitha ato biseda të cilat i thash më herët për të ia ofruar banesën sociale. Në pyetjen e prokurorit se nga kontrata mbi shitblerjen dhe certifikata e pronësisë rrjedh se ju jeni pronarë i palutshmërisë mbi 11 hektarë të cilën e keni blerë nga M. V. së bashku me bashkëpronarët e tjerë ashtu siç thatë më lartë, këtu i akuzuari P. R. shfrytëzon në mënyrë të kundërligjshme këto pasuri, a mundesh me na sqaruar se këtu i akuzuari tash a i mban të gjitha këto prona apo cilën pjesë të kësaj prone? dëshmitari deklaroj se: ai e mban një pjesë të M.it që e ka trashëguar nga M. V. gjegjësisht axha i tij. Shtoi sa i përket dokumenteve që vërtetojnë parcelat e tij të cilat i mbanë në mënyrë të kundërligjshme i pandehuri P. R., e kam vendimin e trashëgimisë T.nr.227/2010 të datës 23.12.2010 të trashëgimlënësit M. V. dhe të gjitha ato parcela i mban të uzurpuara këtu i akuzuari P. R., ndërsa pjesët tjera të patundshmërisë të cilat unë i kam blerë prej bashkëpronarëve-trashëgimtarëve të M.V.it, nuk janë të uzurpuara, pra ato janë të lira dhe i kam në posedim. Me rastin e rimarrjes në pyetje të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit nga ana e mbrojtësit të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 22.04.2024 pyetjen se: me rastin e blerjes se pronës a keni qenë ne teren për të shikuar në mënyrë faktike pronën dëshmitari deklaroi se e kam njohur terrenin komplet, po ashtu edhe në kontratë e shitblerjes terreni është i lirë, i kam shikuar pronat dhe nuk kam pasur vërejtje dhe është e vërtetë se sipas kontratës se shitblerjes e kam marr këtë pronë në shfrytëzim dhe posedim pa pengesa, pra me letra e kam nënshkruar dhe bartë ne emër timin në kadastër në mënyrë të rregullt por në shfrytëzim nuk e kam marr asnjëherë. Se e kujt është paluajtshmëria këtë e ka sqaruar eksperti i gjeodezisë me rastin e daljes ne vend e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor duke i precizuar parcelat te cilat i shfrytëzon këtu i pandehuri P. R.. Shton se unë e kam blerë tere pasurin e familjes V. siç parashihet edhe ne kontratë. Nuk jam në dijeni se a ka pasur ndonjë ankesë nga M. apo anëtari asaj familje dhe se po jam takuar dhe ka qenë prezent edhe avokati i tyre ne Kosovë. Se P. R. e shfrytëzon pronën e M. e kam kuptuar që nga janari i vitit 2023, pasi e kam blerë. Në pyetjen e të akuzuarit se a më ke pyetur mua kur e ke ble tokën dëshmitari deklaroi ; jo sepse unë jam marr vesh me pronarin e tokës e jo me P.se as nuk e kam njohur e nuk e kam ditë se kush është.

3.1.3 Eksperti i gjeodezisë B. M. nga Gjakova, në cilësi të dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 06.12.2023 duke u deklaruar fillimisht në pyetjen e mbrojtësit të akuzuarit av. Prek Kola , se a e keni përpiluar ju ekspertizën dhe a mbeteni pranë kësaj ekspertize ? dëshmitari deklaroi se :po dhe mbetem në tërësi pranë kësaj ekspertize. Shtojë se: *me rastin e daljes ne teren kemi bere identifikimin dhe matjen e sipërfaqes e cila ka qene e rrethuar me tela*

gjembor ,pas incizimit kemi vërejt se pjesa e sip. se rrethuar me tela gjembor përfshinë një pjesë të parcelës 115-0 pjesë ,parcela ne tërësi 116-0,117-0 si e tere ,697-0 e tërë, pjesa 698-0 pjesë, ku është ndërtuar edhe shtëpia e banimit me dimensione 12.20m me 13.14 m, si dhe pjesë e parcelës 692-0.Sipërfaqet e cekuar te parcelave te matura ne teren e te cilat i shfrytëzon P.N.R.i kam shkruar në formë tekstuale ne ekspertizë dhe do ti referohem sipërfaqeve për parc. 115-0 me kulturë livadh e klasit te tretë me sip. 10293 m² ,pjesëe parcelës 698-0 kulturë livadh e klasit te katër ,me sipr. 3853 m² (shtëpia e ndërtuar ne këtë parcelë ka dimensione 13.14m x 12.20 ku gjithë kjo sipërfaqe është 160.30m²). Pjesa 692-0 me kulturë mal i klasit te katër me sipërfaqe 899 m² .Parcela 116-0 me kulturë mal i klasit te katër me sip. 550m² .Parcela 117-0 me kulturë pemishte e klasit te tret me sip. 1033 m² . Parcela 697-0,me kulturë pemishte e klasit te tretë me sip. 1867 m katror .sipërfaqja e përgjithshme e gjendjes faktike e rrethuar me tela gjembor te cilën e shfrytëzon P. R. është 18495 m².si dhe sip. e pjesës se ngastrës 699-0 si rrugë publike në sip. 661m² .Të gjitha këto parcela janë te evidentuara ne flet posedimin nr. 123 në emër të A.K. B.. Pjesa e parcelave te kufizuara ne teren te cilat i shfrytëzon P.N.R.nga Veriu kufizohet me parcelën nr. 114-0 ,118-0,699-0,696-0,694-0., ne pjesën e parcelës 692-0.Nga jugu me parcelën nr,698-0 pjesë ,parcela 699-0 me kulturë rrugë , parc. 115-0 pjesë .Nga ana perëndimore me parcelën nr. 2116-0 me kulturë rrugë publike .Të gjitha të dhënat janë të paraqitura në formë grafike dhe tekstuale të dorëzuar në gjykatë me dt. 23.08.2023. Të gjitha këto janë të konstatuar në akt ekspertizë , pra pjesa 115-0,698-0 dhe 692-0,janë pjesë te shfrytëzuara ,ndërsa parcela 116-0,117-0,697-0, janë ne tërësi. Këto parcela janë evidentuar ne emër te pronarit te cilën e cekem me parë A.K.B., por këto te dhëna mund te merren ne Drejtori për Kadaster dhe Gjeodezi, ndërsa se kur janë regjistruar këto parcela , këto te dhëna mund te merren ne Drejtori për Kadaster dhe Gjeodezi. Perf. i autorizuari i palës se dëmtuar av. Edona Sina , propozoi qe si prova te reja te amnistohen aktvendimi nga Zyra Kadastrale në e Gjakovë , që ka të bëjë me bartjen e pronësisë së A. B. , për te gjitha parcelat qe janë kontekst i kësaj çështje , me te cilat vërtetohet me dt. 13.01.2023 A. B. këtu i dëmtuari është zyrtarisht pronar i të gjitha parcelave me detaje sikur ne prova qe do te dorëzohen ne kopje për gjykatën.

3.2 Provat materiale

3.2.1. -Nga Histori ati i lëshuar nga Drejtoria për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë me nr.11-940-02-2200/20 i datës 24.02.2020 , gjykata ka konstatuar faktin se :se në mungesë të një pjese te madhe te operatit kadastral, qysh nga lufta e fundit e vitit 1999 , për ZK.P. nuk disponojmë me shënime të vitit 1932 e as me ato të vitit 1955, por disponojmë me ato të vitit 1982, ku këtë zone është kryer aero-inqizimi ndërsa shënimet definitive kanë hyrë në fuqi në vitin 1988 dhe rezulton kjo gjendje:

Parcela nr. 105 me kulture are e klasit te katërt ne sipërfaqe prej 1.24.91ha. - parcela nr. 106 me kulture mal e klasit të katërt ne sipërfaqe prej 0.04.50ha, - parcela nr. 107 me kulture kullosë e klasit të peste ne sipërfaqe prej 0,05.16ha, - parcela nr. 115 me kulture livadh e klasit te tretë ne sipërfaqe prej 1.64.13ha, livadh e klasit të katërt në sipërfaqe prej 0.42.09ha, - parcela nr. 116 me kulture kullose e klasit te katërt ne sipërfaqe prej 0.05.50ha. - parcela nr. 117 me kulture pemishte e klasit te trete në sipërfaqe prej 0.10 .79ha, - parcela nr. 691 me kulture kullosë e klasit te katërt në sipërfaqe prej 096.05 ha, - parcela nr. 692 me kulture mal i klasit të katërt ne sipërfaqe prej j 4.30,62ha, - parcela nr. 693 me kulture kullosë e klasit te tretë ne sipërfaqe prej 030.98 ha, - parcela

nr. 697 me kulture pemishte e klasit të tretë ne sipërfaqe prej O. 18.99 ha, = parcela nr. 698 me kulture shtëpi në sipërfaqe prej 0.02.39ha, oborr ne sipërfaqe prej 0.05.00 ha-livadh i klasit të katërt ne sipërfaqe prej 0.84.14ha, = parcela nr. 935 me kulture livadh i katërt në sipërfaqe prej 0.75.,25ha, livadh i klasit të tretë sip prej 0.42.93ha. gjithsejtë në sip. të përgjithshme prej 1 1.43.43 ha, sipas fletë posedimit nr. 123 janë evidentuar në posed të.- M. B. V. dhe M. B. V..

Në vitin 1995, në bazë të Aktvendimit te trashëgimisë, T.nr. 50/95 të datës .29.05.1995, parcelat e lartpërmendura prej: M. B. V. dhe 1/2 M. B. V. , kalojnë në posed të: 7/14 M. B. V., 3/14 S.V., 1/14 M. M. V., 1/14 M. M. V..1/14 I. M. V., 1/14 M.ka V..

Në vitin 2011, në bazë të Aktvendimit të trashëgimisë, T.nr.227/10 të datës 23.12.2010, prapë parcelat e lartpërmendura, prej: 7/14 M. B. V., 3/14 S.V., 1/14 M. M. V. , 1/14 M. M. V.,1/14 I. M. V. .1/14 M.ka M. V.. Kalojnë në posed të : 3/14 S.V., , 8/14 M. M.V., 1/14 M. M. V., 1/14 I. M. V., 1/14 M.ka M. V..

3.2.2 Nga Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë T.nr.50/1995 i datës 29.05.1995, gjykata ka konstatuar faktin se në procedurën e trashëgimisë të ndjerit M. V. ish nga Gjakova me ½ pjesë ideale të trashëgimisë ku sipas kësaj baze ¼ pjesë ideale kanë kaluar në emër të së vejës S.V. , të birit M. V., të bijës M.ka Gj. e lindur V. , të birit I. V. dhe të birit M. V. dhe atë në pjesë përkatëse ideale të ngastrave kadastrale 105,106,115, 116, 117, 691, 692, 693, 698, 935 , me kulturë arë, mal, kullosë , livadh, pemishte, shtëpi dhe oborrë .

3.2.3 Nga Aktvendimi i Gjykatës Komuna në Gjakovë T.nr227/2010 i datës 23.12.2010, gjykata konstaton faktin se në se në procedurën e trashëgimisë, nipi i tij M. (M.) V., ish nga Gjakova, tani me vendbanim në Beograd R. Serbisë, shpallet trashëgimtar legjitim sipas të drejtës së përfaqësimit të trashëgimisë tani të ndjerit të ndjerit M. (B.) V. , ish nga Gjakova, i cili ka vdekur me datë 12.06.1996.

3.2.4 Nga Kontrata për shitblerjen e paluajtshme risë LRP.nr.rendor 577/2023 dhe LRP nr.ref.124/202 të datës 13.01.2023, gjykata ka konstatuar faktin se para noterit F. Z., me kërkesën që bazë të vullnetit të tyre lirë ,u përpilua Kontrata mbi shitblerjen ku si palë Shitëse M. (M.) V , të cilin sipas autorizimit me numër UZZ 13/2023 të datës 10.01.2023 e përpiluar tek Noteri K. M.M. me seli në Rozhajë /Mali i Zi , e përfaqëson i autorizuari Teki (Haki) Bokshi av. nga Gjakova dhe shitësve tjerë S.V, I. (M.) V. , M. (M.) V. , M.ka (M.) V. me pjesët e pronës si në bashkëngjitur aktit noterial dhe palës Blerëse A.(K).B. me çmimin e shitjes në shumë prej 450.000.oo (katërqind e pesë mijë) euro, ku palët kontraktuese janë pajtuar me mënyrën e pagesës me të cilën menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate e më së largu në afatin prej 8 ditësh pune do të paguhen në llogarinë e përcaktuar të shitësit M. V ,bares i numrit personal . . në llogarinë bankare . . Account ëith institucion/Beneficiary's Bank: KOBRSB-NLB KOMERCIALNA BANKA Beograd me adresUl. Sveti Savan r.14. 110000 Beograd R.Srbija, , Dintermediary Bank /Correspondent Bank SËIFT-BIC: DEUTSDEFF, DEUCHE BANK AG , Frankfurt am Main , Germany , me transfer ndërkombëtar.

3.1.5 Nga kopja e fletëpagesës në emër të A. B. , e datës 15.01.2023 gjykata ka konstatuar faktin se rreth orës 13:28:31 , është bërë bartja e mjeteve në shumë prej 450.000,00 Euro shitësit M.V. nga Beogradi R. Serbisë me banim në Rr.” . . ” E nr. . .

3.2.6 Nga certifikata nga Agjencia Kadastrale e Kosovës , me numër të lëndës 479-23, të datës 23.02.2023, paluajtshme ia e cekur në te ka kaluar në pronësi të A(K). B..me ID. . .

3.2.7 Nga Aktvendimi nga Zyra Kadastrale ne Gjakovë, me numër referent i lëndës 967-23 të datë 18.01.2023, gjykata ka konstatuar faktin se është Aprovuar –kërkesa e parashtruar nga A.(K.) B. , i pajisur me pasaportë me numër . . të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të Holandës e cila ka të bëjë me Bartjen e posedimit –Blerje sipas aktit juridik kontratë për shitblerje të paluajtshme risë LRP.Nr.Rendor .577/2023 , LRP.Nr.ref.e datës 13.01.2023 në njësit kadastrale si në aktvendim.

3.3 Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në mbrojtjen e tij duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e mbrojtësit ka deklaruar se: Unë kam ik në Shqipëri nga viti 1994, nga regjimi serb, në muajin nëntor i vetëm duke lënë familjen në Kosovë. *Me datën 25.08.1999, kam hy në pronën e M. V.it, duke mos e ditur që i njëjti ka qenë i vrarë.* Ka ardhur Habitati i Pejës me më larguar nga aty, kanë lanë shiritat në vend të M.it dhe M., por gruaja i ka thanë se nuk është ky vendi i M.it, por prapë se prapë i kanë vendos shiritat. Kjo ka ndodhur në vitin 2003-2004. Me kanë ftuar dhe me kanë pyetur se a i përgjigjesh ti pronarit të tokës M. V.it, i kam thanë po. Me pas ka ardhur edhe policia e ULEX-it dhe e kanë rrethuar tokën dhe nga ajo kohë nuk ka ardhur askush .A. B.n nuk e kam njohur e as që e njoh dhe ai nuk e di cila është prona e M., e që unë e shfrytëzoj krejt tokën e M. që e ka konstatuar edhe eksperti i gjeodezisë, unë nuk kam pasur ankesë nga anëtarët e M. por vetëm nga M.i për tokën e vet, pra mos me ja shfrytëzua. Pra tokën e M. e shfrytëzoj 4h e 30a, ndërsa pjesën tjetër të M. e shfrytëzon familja Rr.. Në këtë paluajtshmëri jetojë me 27 anëtarët e familjes jetojmë në ato prona dhe asnjëherë nuk kam paguar qira, duke shtuar se nuk kam asgjë me shtuar me që unë jam në tokën time dhe nuk kam kujt ti përgjigjem por vetëm shtetit. Po jam në dijeni se është paraqitur padi civile ndaj meje nga M. V., të cilin nuk e njoh. Në pyetjen e Prokurorit se a je në dijeni se këto parcela që janë objekt i aktakuzës kanë qenë pronë e M. V.it e me pas janë bartë në pronësi të dëmtuarit A. B.? I akuzuari deklaroj se janë bartë duke i falsifikuar pjesën e M.. Në pyetjen e Prokurorit të shtetit: a ke qenë prezent kur eksperti i gjeodezisë e ka bërë matjen e parcelave të cilat i shfrytëzon ti? I akuzuari deklaroj se po dhe se vet unë e kam njoftuar ekspertin se cilat parcela i shfrytëzoj. Se këto parcela kanë kaluar në emër të A. B.t ka afro 2 vite që e kam kuptuar nga Gj S. (Q.), me ka thanë se tokën e M. e bleu A. B., ndërkohë ka ardhë dhe me ka thanë se e ka blerë edhe të e M., e unë i kam thanë se nuk ka të drejt pa me pyetur mua sepse unë nuk kam pas ku të shkojë, e kam shkua në tokën e M. e unë i përgjigjem vetëm shtetit. As A. e as askush nuk ka ardhur për tokë. Atë tokë akoma e shfrytëzoi dhe kam mbjellë kallamboq ku për momentin në Kosovë jetojë vetëm unë dhe gruaja të tjerët jetojnë ne Evropë. Në pyetjen e përfaqësueses së autorizuar të dëmtuarit av. Edona Sina se ke qenë luftuar i UÇK-së, a je përfitues i veteranëve, i akuzuari deklaroi se jo sepse kur kam shkua ne B. Currë ka pasur mos përputhje të emrit, kam jap edhe intervistë në

TV nga shtëpia ime dhe jam pyetur lidhur me pensionin e veteranit, i akuzuari ka deklaruar se po më kanë pyetur por unë i kam thanë jo sepse ka pasur problem me emrin. Në pyetjen e Perf. të autorizuar av. E. S, se a je takuar ndonjëherë me A. B., i akuzuari deklaroi se po dhe i kam thanë se kam dëgjuar se ke blerë token e M.it, ai me tha se unë nuk e kam ble por e kanë blerë djemtë e axhës, e unë jam i ndarë me ta.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 332 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se veprën penale të uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme e kryejnë: *“kushdo që në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj”*. Pra, kur pushtimi i një prone të tillë (futja në posedim të pronës së paluajtshme nuk është bërë me pëlqimin e pronarit legjitim apo kur nuk është i mbështetur mbi ndonjë veprim ligjor juridik. *Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe për të ekzistuar përgjegjësia e kryesit është e nevojshme dashja e tij që përfshin në vete vetëdijen e tij se po e pushton pronën e huaj, pa leje të pronarit legjitim dhe kjo nënkupton se elementet e kësaj vepre janë konsumuar vetëm kur pushtimi i pronës është bërë pa pëlqimin e pronarit apo të afërmeve të tij dhe me këtë rast nuk është e domosdoshme që pëlqimi të jetë vetëm formal, i shkruar por mund të jetë edhe gojor.*

5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata pas administrimit të provave materiale dhe personale, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se i akuzuari P. R. me veprimet e tij ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i paluajtshmërisë në vazhdimësi nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke e shfrytëzuar tokën pa pëlqimin e pronarit legjitim apo mbi ndonjë veprim ligjor juridik të cilën pronë akoma e shfrytëzon.

Kjo gjendje faktike gjykata fillimisht e ka vërtetuar përmes deklaramit të të akuzuarit, i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se *“me datën 25.08.1999, kam hy në pronën e M. V.it, duke mos e ditur që i njëjti ka qenë i vrarë”*, më pas ka ardhur edhe policia e EULEX-it dhe e kanë rrethuar tokën dhe nga ajo kohë nuk ka ardhur askush .A. B.n nuk e kam njohur e as që e njoh dhe ai nuk e di cila është prona e M., e që unë e shfrytëzoj krejt tokën e M. që e ka konstatuar edhe eksperti i gjeodezisë. Pra tokën e M. e shfrytëzoj 4h e 30a, ndërsa pjesën tjetër të M. e shfrytëzon familja Rr.. Në këtë paluajtshmëri jetoj me 27 anëtarët e familjes jetojmë në ato prona dhe asnjëherë nuk kam paguar qira, duke shtuar se nuk kam asgjë me shtuar me që unë jam në tokën time dhe nuk kam kujt ti përgjigjem por vetëm shtetit. Po ashtu ka deklaruar se është në dijeni se këto parcela që janë objekt i aktakuzës kanë qenë pronë e M. V.it janë bartë duke i falsifikuar pjesën e M.. Ka shtuar se ka qenë prezent kur eksperti i gjeodezisë e ka bërë matjen e parcelave të cilat i shfrytëzoi dhe n vet unë e kam njoftuar ekspertin se cilat parcela i shfrytëzoj. Se këto parcela kanë kaluar në emër të A. B.t ka afro 2 vite që e kam kuptuar nga Gj S. (Q.), me ka thanë se tokën e M. e bleu A. B., ndërkohë ka ardhë dhe me ka thanë se e ka blerë edhe të e M., e unë i kam thanë se nuk ka te drejt pa me pyetur mua sepse unë nuk kam pas ku të shkojë, e kam shkua në tokën e M. e unë i përgjigjem vetëm shtetit

Gjykata nga provat e administruara ka gjetur se është jokontestues fakti se i akuzuari P. R., me veprimet e veta ka kryer veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës se paluajtshme në vazhdimësi nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës , duke hyre në paluajtshmëritë e cekura dhe në objektin e banimit ne të cilën nuk ka kërkuar ndonjë të drejte të banimit, të drejtën e shfrytëzimit pa pëlqimin e pronarit legjitim apo mbi ndonjë veprim ligjore juridik e të cilën prone akoma e shfrytëzon, .

Gjykata këtë gjendje faktike e ka konstatuar edhe nga dëshmia e të dëmtuarit M. V., me provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor si dhe nga Historiati i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë me nr.11-940-02-2200/20 i datës 24.02.2020 se paluajtshmëria e përshkruar gjithsejtë në sip. të përgjithshme prej 1 1.43.43 ha, sipas fletë posedimit nr. 123 janë evidentuar në posed të.- M. B. V. dhe M.B. V.. Ky fakt është vërtetuar edhe nga Aktvendimi i Gjykatës Komuna në Gjakovë T.nr.227/2010 i datës 23.12.2010, me të cilin konstatohet fakti se e në procedurën e trashëgimisë, nipi i tij M. (M.) V., ish nga Gjakova, tani me vendbanim në Beograd R. Serbisë, shpallet trashëgimtar legjitim sipas të drejtës së përfaqësimit të trashëgimisë tani të ndjerit të ndjerit M. (B.) V. , ish nga Gjakova, i cili ka vdekur me datë 12.06.1999. Se i akuzuari P. R. ka uzurpuar paluajtshmërin vërtetohet edhe nga deklarata e tij e dhënë në stacionin policor para zyrtarëve policor me datën 06.11.2018 ka deklaruar se: me datë 25.08.1999 pas përfundimit të luftës jemi kthyer në Kosovë nga Shqipëria dhe posa jemi kthyer drejt kemi shkuar dhe jemi futur në shtëpinë sa e di unë ka qenë e të M. V., arsyeja se pse jam futur në atë shtëpi është se pse nuk kisha se ka të shkoj dhe të strehohem, kështu edhe në ditën e sotme jam në atë shtëpi.

Për më tepër, se i akuzuari akoma është duke e shfrytëzuar këtë paluajtshmëri vërtetohet edhe nga deklarata e ti se edhe pse këto parcela kanë kaluar në emër të A. B.t ,ka afro 2 vite që e kam kuptuar, e unë kam thanë se ai nuk ka të drejt pa me pyetur mua sepse unë nuk kam pas ku të shkojë, e kam shkua në tokën e M. e unë i përgjigjem vetëm shtetit edhe përkundër faktit se nga Kontrata për shitblerjen e paluajtshme risë LRP.nr.rendor 577/2023 dhe LRP nr.ref.124/202 të datës 13.01.2023, ku si palë Shitëse M. (M.) V , të cilin sipas autorizimit me numër UZZ 13/2023 të datës 10.01.2023 e përpiluar tek Noteri K. M.M. me seli në Rozhajë /Mali i Zi , e përfaqëson i autorizuari Teki (Haki) Bokshi av. nga Gjakova dhe shitësve tjerë S.V, I. (M.) V. , M. (M.) V., M.ka (M.) V., me pjesët e pronës si në bashkëngjitur aktit noterial dhe palës Blerëse A.(K.B.. Po ashtu nga certifikata nga Agjencia Kadastrale e Kosovës , me numër të lëndës 479-23, të datës 23.02.2023, paluajtshmëria e cekur në të ka kaluar në pronësi të A(K). B.me ID. . . . Pra nga vet deklarata e të pandehurit dhënë në polici dhe në gjykatë , vërtetohet se i njëjti ka qenë plotësisht i vetëdijshëm që nuk posedon me dokumentacion për këto prona, i ka shfrytëzuar duke mos paguan asnjëherë qira për këto toka, edhe pse ka deklaruar se ka dy vite që e ka kuptuar se këto parcela kanë kaluar në emër të A. B.t, të njëjtat i shfrytëzon duke i konsideruar tokë të tij dhe se për këtë nuk i përgjigjet askujt përveç shtetit

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e të akuzuarit P. R.t të dhënë në mbrojtjen e tiji cili ka theksuar se me datën 25.08.1999, kam hy në pronën e M. V.it, duke mos e ditur që i njëjti ka qenë i vrarë. Me pas ka ardhur edhe policia e ULEX-it dhe e kanë rrethuar tokën dhe nga ajo kohë nuk ka ardhur askush .A. B.n nuk e kam njohur e as që e njoh dhe ai nuk e di cila është

prona e M., e që unë e shfrytëzoj krejt tokën e M. që e ka konstatuar edhe eksperti i gjeodezisë. Pra tokën e M. e shfrytëzoj 4h e 30a, ndërsa pjesën tjetër të M. e shfrytëzon familja Rr.. Në këtë paluajtshmëri jetojë me 27 anëtarët e familjes jetojmë në ato prona dhe asnjëherë nuk kam paguar qira, duke shtuar se nuk kam asgjë me shtuar me që unë jam në tokën time dhe nuk kam kujt të përgjigjem por vetëm shtetit. Gjykata konstatoi se të njëjtat janë të pa bazuara, të pa argumentuara në asnjë provë apo dëshmi të vetme dhe se e ka konsideruar vetëm përpjekje e të akuzuarit për të ju shmangur apo ikur përgjegjësisë penale.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi sui dhe faktin se i njëjti sipas evidencës të gjykatës evidentohet me këto lëndë penale me aktgjykimin P.nr.68/2000, P.nr.320/2011, P.nr.392/10 dhe P.nr.310/2001, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar personalitetin e të akuzuarit, moshën e tij të shtyrë, atë i 8 fëmijëve si dhe sjelljen e të akuzuarit në gjykatë. Duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

6. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, në emër të ekspertizave si taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt juridiko civil, gjykata e ka bazuar në nenin 462 të KPP-së, pasi që nga të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka vlerësuar se nuk ka bazë të sigurt për detyrimin e të pandehurit për kompensimin e dëmit material dhe jo material, siç ka kërkuar i dëmtuari.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 359, 360, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.844/18, me datë 29.05.2024

Sekretarja Juridike
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.